



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1541/6 Prot

Tiranë, më 02.11.2022

VENDIM

Nr. 42, datë 02.11.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1541 Prot., datë 14.09.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, bazuar në përgjigjen e kërkesës për informacion me numër rendor 01, datë 02.06.2022, që lidhet me situatën e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 2.10.2019 “*Për sigurimin e ndërtimeve*”, në të cilën Autoriteti Publik ka deklaruar se: “*...në vazhdim, ka monitoruar ofrimin e këtij produkti të detyrueshëm, nëpërmjet raportimeve të bëra nga shoqëritë e sigurimit*”, nëpërmjet kërkesës datë 29.08.2022, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni në lidhje me:

1. *Bazuar në këto kontrolle a ka konstatuar Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare një situatë të shpërpjestuar sa i përket raporteve mes kompanive të sigurimit?*
2. *Nga kontrollet që keni ushtruar a keni konstatuar praktikën që Kompanitë e Sigurimit bëjnë oferta për sigurimin e godinave deri në 50 përqind më të ulëta se sa limiti fundor i përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 2.10.2019 “Për sigurimin e ndërtimeve”?*

3. *A është risiguruar nga kompanitë e sigurimit ky portofol që konsiderohet me rrisht të lartë, për të garantuar sigurinë e klientëve?*

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 13.09.2022, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *“...Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim, “AMF”) ushtron funksionet e tij bazuar në ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar. Informacioni dhe çdo e dhënë që AMF disponon ose merr në funksion të ushtrimit të detyrave mbikëqyrëse dhe rregullative trajtohet si informacion konfidencial. Ruajtja dhe mospërhapja e këtij informacioni është detyrim që buron nga ligji nr. 9572, datë 3.7.2006, i ndryshuar. Sipas këtij ligji, neni 24 (Konfidencialiteti) “Të dhënat, që i vihen në dispozicion Autoritetit për veprimtarinë e subjektit të mbikëqyrur, klasifikohen “Informacion konfidencial” nëse përhapja e tyre çënon interesat tregtarë ose emrin e mirë të subjektit... Anëtarët e Bordit, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit janë të detyruar t’i ruajnë dhe të mos i shpërndajnë informacionet konfidenciale”. Informacioni konfidencial trajtohet gjithashtu sipas Rregullores nr. 114, datë 11.09.2008 “Për konfidencialitetin në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar. Në kuadër të detyrimit për transparencë dhe mbrojtjes konsumatore, AMF informon publikun bazuar në Rregulloren nr. 75, datë 30.05.2016 “Për komunikimin me median e publikun, publikimet dhe funksionimin e faqes së internetit” e ndryshuar, dhe programin e transparencës. Kjo rregullore, përcakton procedurat në lidhje me funksionimin sa më të mirë të komunikimit të AMF-së me median dhe publikun, përmbajtjen dhe klasifikimin e publikimeve, si dhe hartimin dhe funksionimin e faqes zyrtare të internetit të AMF-së”.*

Në vijim, pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi pretendon se nuk i është vënë në dispozicion informacioni/dokumentacioni i kërkuar sipas kërkesës për informacion.

Në këto kushte, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 1541/1 prot., datë 21.09.2022 kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik me shkresën nr 2255/1 Prot., datë 27.09.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1541/2 Prot., datë 28.09.2022 ka rikonfirmuar qëndrimin e trajtuar

si më sipër, duke bërë me dije gjithashtu se: *“...AMF në zbatim të rregulloreve të cituara në përgjigjen datë 13.09.2022, informon publikun vazhdimisht nëpërmjet botimeve periodike ose joperiodike të tij të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare... Këto publikime por edhe publikime joperiodike të tjera në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së Autoritetit janë lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të AMF-së”*.

Ankuesi, pas qëndrimit të sipërcituar të Autoritetit Publik, me e-mail-in datë 05.10.2022, ka vijuar ankimin e regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr.1541/3 Prot., datë 05.10.2022 duke cituar se: *“... Përgjigja e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare edhe ndaj Zyrës së Komisionerit, vijon të jetë në koherencë me përgjigjet e mëparshme duke treguar qëndrimin e këtij institucioni kundër detyrimit për transparencë ndaj opinionit publik. Pyetjet drejtuar këtij institucioni të rëndësishëm për jetën ekonomike por edhe sociale në vend kanë qenë konkrete dhe që kërkonin përgjigje të detajuara që lidhen me sjelljen e aktorëve në treg sa i përket legjislacionit në fuqi për sigurimin e detyrueshëm të godinave. Në këtë proces janë konstatuar shkelje të rënda ligjore nga aktorë të tjerë institucional si Ministria e Drejtësisë, Dhoma e Noterëve dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës.”*

Në këto kushte, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”,* bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë si dhe bëri me dije për Autoritetin Publik se informacionin e kërkon në cilësinë e gazetarit për një botim i cili do t'i shërbejë interesit publik. Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit i kërkoi përfaqësuesve të Autoritetit Publik për të rivlerësuar qëndrimin e mbajtur, në të kundërt të argumentojnë refuzimin në përputhje me nenin 17 të LDI, brenda datës 19.10.2022.

Në vijim, Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 19.10.2022, ka depozituar konkluzionet përfundimtare duke rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur sa më sipër se: *“...Informacioni dhe çdo e dhënë që AMF disponon ose merr në funksion të ushtrimit të detyrave mbikëqyrëse dhe rregullative trajtohet si informacion konfidencial. Ruajtja dhe mospërhapja e këtij informacioni është detyrim që buron nga ligji nr. 9572, datë 3.7.2006, i ndryshuar, më konkretisht neni 24, ku përcaktohet se: “Të dhënat, që i vihen në dispozicion Autoritetit për veprimtarinë e subjektit të mbikëqyrur, klasifikohen “Informacion konfidencial” nëse përhapja e tyre çënon interesat tregtarë ose emrin e mirë të subjektit...Klasifikimi i informacionit bëhet me rregullore të brendshme, të miratuar nga Bordi. ...Anëtarët e Bordit, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit janë të detyruar t'i ruajnë dhe të mos i shpërndajnë informacionet konfidenciale”*.

Ruajta e konfidencialitetit është detyrim bazuar dhe në ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, neni 72, pika 2 dhe 5, ku parashikohet se “...shoqëria e sigurimit jep informacion kur ...informacioni kërkohej nga Autoriteti ose nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse, me qëllim ushtrimin e mbikëqyrjes brenda kompetencave të tyre”. “Autoriteti, autoritetet e tjera mbikëqyrëse, organet hetimore dhe gjyqësore e përdorin informacionin e parashikuar në pikën 2, të këtij neni, vetëm për qëllimet për të cilat është dhënë informacioni”.

Në zbatim të parashikimeve më sipër, Autoriteti ka detyrimin jo vetëm për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit dhe të dhënave të marra nga subjektet nën mbikëqyrje, por dhe ta përdorë këtë informacion vetëm për qëllime të ushtrimit të mbikëqyrjes brenda kufirit të kompetencave të tij.

Në zbatim të nenit 24, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, (cituar më sipër) Bordi i Autoritetit ka miratuar Rregulloren nr. 114, datë 11.09.2008 “Për Konfidencialitetin në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar. Kjo rregullore në nenin 3, parashikon “Informacionin jopublik” në AMF. Sipas nenit 3, informacioni jopublik në Autoritet klasifikohet në informacion “sekret shtetëror”, i cili trajtohet sipas ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” dhe “informacion konfidencial”.

Në pikën 3.1, të nenit 3, të rregullores nr.114, renditet lloji i informacionit që konsiderohet jopublik, më konkretisht konsiderohet si informacion jopublik informacioni:

- a. që çënon sigurinë kombëtare;*
- b. që çënon pavarësinë e Republikës së Shqipërisë;*
- c. që çënon mbrojtjen e integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë;*
- d. që çënon rendin kushtetues;*
- e. që çënon interesat ndërkombëtare:
 - i. Në marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me çdo shtet tjetër;*
 - ii. Në marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me organizatat ndërkombëtare.**
- f. që çënon interesat ekonomike dhe tregtare të personave;*
- g. që çënon interesat financiare të administratës në Republikën e Shqipërisë;*
- h. që çënon interesat financiare të personave nëpërmjet spekulimeve në monedha, letra me vlerë dhe në tregtimin e mallrave;*
- i. që çënon procesin hetimor dhe gjyqësor të çështjeve;*
- j. që çënon veprimtarinë mbikëqyrëse dhe kushtet e ushtrimit të veprimtarisë mbi subjektet e mbikëqyrura;*
- k. që lidhet me raportet e ekzaminimit;*
- l. që çënon privatësinë dhe personalitetin e personave;*
- m. që çënon punën dhe veprimtarinë ndërmjet strukturave të brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;*
- n. Çdo informacion tjetër, përfshirë dhe vetë kërkesën për informacion, i përftuar nga institucionet vendase dhe të huaja, i klasifikuar nga këto institucione si informacion konfidencial.*

Sipas nenit 4, pika 4.3, të po kësaj rregullore “Një person mund të njihet me një informacion jopublik, nëse ai siguron një të drejtë njohjeje nga një drejtues institucioni apo nga personi, të cilit me ligj i është njohur një e drejtë e tillë, kur: a. Personit i njihet e drejta me ligj për njohjen me informacionin; b. Personi ka firmosur një deklaratë që vërteton se informacioni i marrë do të mbetet konfidencial gjatë gjithë kohës që ky informacion klasifikohet si konfidencial nga Autoriteti dhe që personi është ligjërishit përgjegjës për ruajtjen e konfidencialitetit gjatë kësaj periudhe; c. Personi ofron kushtet e nevojshme për mbrojtjen e informacionit të përcaktuar me ligj.

Duke ju kthyer objektit të ankimit të z. , AMF ka konstatuar se pyetjet e drejtuara nga kërkuesi dhe informacioni i kërkuar në kuptim të dispozitave ligjore të cituara më sipër konsiderohet si informacion konfidencial. Të dhënat e marra nga shoqëritë e sigurimeve si pasojë e inspektimeve, raportimeve periodike, si dhe çdo informacion apo dokument tjetër trajtohen si konfidencial dhe përdoret vetëm për qëllime mbikëqyrje.

Sjellim në vëmendje të Komisionerit se pyetjet e shtruara nga z. Bregu, kërkojnë jo vetëm informacion konfidencial, por kërkojnë gjithashtu një analizim të të dhënave dhe përpunim të dedikuar posaçërisht për kërkuesin, gjë që tejkalon dhe parashikimet e nenit 3, të LDI, ku përcakton se “Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar”. “3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij...” Sipas nenit më sipër subjekti kërkues ka të drejtë të njihet me informacion publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij...”

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi ka vijuar me ankimin e regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1541/5 Prot., datë 26.10.2022, duke kërkuar vënien në dispozicion të informacionit në formatin e zotëruar.

Në përfundim, pas konsultimit të legjisllacionit të posaçëm, Komisioneri vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga ana e Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: “Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjisllacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”. Në kuptim të këtij parashikimi, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është Autoritet Publik dhe subjekti i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës, pavarësisht se informacioni i prodhuar është si rezultat i veprimtarisë së këtij autoriteti në zbatim të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, legjisllacion ky i cili nuk parashikon përjashtimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nga zbatimi i detyrimeve që burojnë nga LDI.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar konstatohet se, Autoriteti Publik pasi deklaroi se informacioni i kërkuar prodhohet në bazë të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, citon si argument për kufizim, nenin 24 të tij, në të cilin citohet se:

“Të dhënat, që i vihen në dispozicion Autoritetit për veprimtarinë e subjektit të mbikëqyrur, klasifikohen “Informacion konfidencial” nëse përhapja e tyre cenon interesat tregtarë ose emrin e mirë të subjektit.

Nuk janë informacione konfidenciale të dhënat tregtare, të siguruara nga subjekti i mbikëqyrur, detyrimi për botimin e të cilave është parashikuar nga ky ligj apo nga ligje të tjera. Klasifikimi i informacionit bëhet me rregullore të brendshme, të miratuara nga Bordi.

Anëtarët e Bordit, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit janë të detyruar t’i ruajnë dhe të mos i shpërndajnë informacionet konfidenciale.

Për rastet kur vërtetohen shkelje të detyrimeve të parashikuara në këtë nen, merren masa administrative deri në lirimin nga detyra, për anëtarët e Bordit, ose largimin nga detyra, për nëpunësit e tjerë të Autoritetit”.

Ndërkohë, Autoriteti Publik referon edhe pikën 2 dhe 5 të nenit 72 të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, ku parashikohet se *“...shoqëria e sigurimit jep informacion kur ...informacioni kërkohet nga Autoriteti ose nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse, me qëllim ushtrimin e mbikëqyrjes brenda kompetencave të tyre”.* *“Autoriteti, autoritetet e tjera mbikëqyrëse, organet hetimore dhe gjyqësore e përdorin informacionin e parashikuar në pikën 2, të këtij neni, vetëm për qëllimet për të cilat është dhënë informacioni”.*

Në zbatim të parashikimeve më sipër, Autoriteti ka detyrimin jo vetëm për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit dhe të dhënave të marra nga subjektet nën mbikëqyrje, por dhe ta përdorë këtë informacion vetëm për qëllime të ushtrimit të mbikëqyrjes brenda kufirit të kompetencave të tij.

Gjithashtu, Autoriteti Publik citon edhe Rregulloren nr. 114, datë 11.09.2008 “Për Konfidencialitetin në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar, ku në nenin 3, parashikon “Informacionin jopublik” në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Sipas nenit 3, informacioni jopublik në Autoritet klasifikohet në informacion “sekret shtetëror”, i cili trajtohet sipas Ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” dhe “informacion konfidencial”.

Në pikën 3.1, të nenit 3, të rregullores nr.114, renditet lloji i informacionit që konsiderohet jopublik, më konkretisht konsiderohet si informacion jopublik informacioni:

...

j. që cënon veprimtarinë mbikëqyrëse dhe kushtet e ushtrimit të veprimtarisë mbi subjektet e mbikëqyrura;

k. që lidhet me raportet e ekzaminimit;

...

m. që cënon punën dhe veprimtarinë ndërmjet strukturave të brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;

...

Sipas nenit 4, pika 4.3, të po kësaj rregullore “Një person mund të njihet me një informacion jopublik, nëse ai siguron një të drejtë njohjeje nga një drejtues institucioni apo nga personi, të cilit me ligj i është njohur një e drejtë e tillë, kur: a. Personit i njihet e drejta me ligj për njohjen me informacionin; b. Personi ka firmosur një deklaratë që vërteton se informacioni i marrë do të mbetet konfidencial gjatë gjithë kohës që ky informacion klasifikohet si konfidencial nga Autoriteti dhe që personi është ligjërishhtë përgjegjës për ruajtjen e konfidencialitetit gjatë kësaj periudhe; c. Personi ofron kushtet e nevojshme për mbrojtjen e informacionit të përcaktuara me ligj.

Nëse do të analizonim dispozitat e sipërcituara në raport me kërkesën për informacion, del qartë se Autoriteti Publik ka bërë një interpretim të gabuar të tyre. Objekti i kërkesës për informacion nuk konsiston në emra konkretë të subjekteve të mbikëqyrur të cilëve nga përhapja e informacionit mund t’ju cënohet interesi tregëtar apo emri i mirë i tij, por në të dhëna të përgjithshme të cilat kanë dalë nga mbikëqyrja e realizuar nga ky Autoritet Publik. Të dhëna këto, të cilat mund të bëhen pjesë e raporteve të cilat publikohen nga ky Autoritet Publik në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së tij.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se, parashikimet e dispozitave të sipërcituara janë të zbatueshme për ato raste kur informacioni nuk përbën informacion publik në kuptim të LDI dhe dhënia e tij kryhet në një kontekst të caktuar.

Përveç këtij konstatimi, gjatë seancës dëgjimore Autoritetit Publik i’u dha mundësia për të rivlerësuar qëndrimin ose të argumentonte refuzimin në përputhje me nenin 17 të LDI. Në vijim, Autoriteti Publik nuk provoi apo argumentoi, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Në pikën 6 të këtij neni, parashikohet se: “...Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”. Bazuar në këtë parashikim, Autoriteti Publik duhet të kishte vlerësuar individualisht çdo pikë të kërkesës për informacion, duke provuar dhe argumentuar mbi cilën pikë të nenit 17 bazohet kufizimi i informacionit, vlerësim i cili nuk rezulton të jetë bërë.

Për rrjedhojë, Autoriteti Publik nuk mund të bazojë kufizimin e një të drejte kushtetuese, vetëm mbi argumentin se *Informacioni i kërkuar konsiderohet si “informacion konfidencial”*.

Autoriteti Publik pretendon gjithashtu se *ky i fundit informon publikun bazuar në Rregulloren nr. 75, datë 30.05.2016 “Për komunikimin me median e publikun, publikimet dhe funksionimin e faqes së internetit” e ndryshuar, dhe programin e transparencës. Kjo rregullore, përcakton procedurat në lidhje me funksionimin sa më të mirë të komunikimit të AMF-së me median dhe publikun, përmbajtjen dhe klasifikimin e publikimeve, si dhe hartimin dhe funksionimin e faqes zyrtare të internetit të AMF-së.*

Në lidhje me këtë pretendim Komisioneri vlerëson se, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, LDI bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: *1) informacioni që bëhet publik pa kërkesë dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar.*

Në kategorinë e parë, përfshihen ato kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vendosen në dispozicion nga autoriteti publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti, e cila është dhe kategoria për të cilën mund të qëndronte argumenti i paraqitur nga Autoriteti Publik. Ndërkohë, rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, pasi kemi të bëjmë me një kërkesë për informim të depozituar pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI, e cila rrjedhimisht duhet trajtuar sipas këtyre dispozitave.

Gjithashtu, Autoriteti Publik në vijim të seancës dëgjimore pretendoi se: *“...informacioni i kërkuar kërkon një analizim të të dhënave dhe përpunim të dedikuar posaçërisht për kërkuesin, gjë që tejkalon dhe parashikimet e nenit 3, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, konstatohet se ky autoritet nuk ka respektuar detyrimin e përcaktuar në pikën 1 të nenit 12 të LDI në të cilën parashikohet se: *“Në rastet kur autoriteti publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim, është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, ai kontakton menjëherë, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës, me kërkuesin për të bërë sqarimet e nevojshme. Në çdo rast, autoriteti publik ndihmon kërkuesin në saktësimin e kërkesës.”* Në këto kushte, ky argument i Autoritetit Publik nuk mund të qëndrojë.

Megjithatë, Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur Autoriteti Publik pranon zotërimin e informacionit, por jo në formatin e kërkuar, ai rrjedhimisht përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se: *“Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”*. Në këto kushte, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuesit/ankuesit informacionin në formatin e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë kufizimet sipas nenit 17 të LDI dhe legjislacionit të posaçëm.

Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore u konstatua se kërkuesi/ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik.

Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

E drejta për informim, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t’i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”*.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1541 Prot., datë 14.09.2022, nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 29.08.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 09.11.2022.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 02.11.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi